



Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit, mujore,
gazetamokra@yahoo.com www.poradeci.com/mokra

Nr. 8 (203) Qershor 2015
Kryeredaktor: FLORI SLATINA

ÇMIMI 20 LEKE

60 MIJË VOTUESIT E POGRADECIT DO TË NXJERRIN KRYETARIN E RI TË BASHKISË, MË 23 QERSHOR

Beteja për votën e mokrarrëve

Dy kandidatët kryesorë do të synojnë të marrin votat e mokrarrëve që janë përcaktuese për fituesin

Pse do (duhet) të fitojë Eduart Kapri

Nga Flori SLATINA

Gara për kreun e ri të Bashkisë Pogradec është në metrat e fundit. Mbi 2 muaj fushatë, në çdo lagje, komunë, fshat e në çdo shtëpi, të dy kandidatët kanë shpalosur idetë dhe programin e tyre, me shpresë se do të bindin bashkëqytetarët e tyre për votën e 21 qershorit. Edi Kapri, kandidati djathtë i aleancës "Punë dhe dinjitet" shprehet i bindur në fitoren e tij.

Dhe ja pse do fitojë Edi Kapri:

1. Sepse është mokrarr dhe ka mbështetjen e pjesës më të madhe të Mokrës, Mokrës së Poshtme e të Sipërme, ka një rrjet të madh miqësie, lidhjesh familjare, krushqie e shoqërore, farefis e kushërinj. Mokra përbën pjesën dërrmuese të zgjedhësve, me mijëra votues.

2. Sepse do marrë edhe votën e pogradecarëve që e duan dhe e vlerësojnë

3. Sepse për mëse dy mandate Pogradecin e kanë qeverisur të majtët në pushtetin lokal (bashki e komuna), të cilët kanë abuzuar jo vetëm me paratë, por edhe me besimin e zgjedhësve dhe gjendja në Mokër e në Pogradec është e mjeruar, e pashpresë

4. Sepse di të menaxhojë, të fitojë dhe të qeverisë. Ka dhënë prova për sukses në biznes e karrierën e tij.

5. Sepse nuk është fukara dhe që do të pasurohet nga vota e bashkëqytetarëve të tij. Nuk është si fukarenjtë e djeshëm që "i zuri nata të varfër e mëngjesi zengjinë."

6. Sepse do të marrë edhe votën e të majtëve, të cilët nuk shohin një përfaqësim real të bindjeve të tyre politike tek e majta.

7. Keq-qeverisja e Edi Ramës, që në Pogradec ka shtuar më shumë varfërinë, mjerimin, sepse jo vetëm që s'ka hapur vende pune, por shkatërroi gjithë ato biznese, me titol e ruspa.

Edi Kapri duhet të fitojë sepse:

1. Duhet t'ju japë fund agallarëve të djeshëm të pushtetit të majtë, të korruptuar e të paafte, të majmur nga karrigia e këtyre viteve "qeverisje".

2. Të qeverisë realisht, të jetë qytetari në qendër dhe jo partia, pasi ai nuk ka një lidhje të fortë partiake

3. Duhet një ndryshim i dukshëm, një menaxhim i mirë i gjithë burimeve të Bashkisë, të keqpërdorura e shpërdurua nga pushteti i djeshëm

4. Duhet një njeri që t'u kthejë shpresën qytetarëve që po lënë qytetin nga mjerimi

5. Duhet që t'i vejë fre ambicies së Ramës për pushtet të pakufijshëm (ëndërra e tij për të fituar 61 bashki!!)

6. Sepse për mokrarrët, për të gjithë njerëzit e aftë, pa dallime partiake, për gjithë njerëzit në nevojë, Bashkia do të jetë e hapur, një vend ku do qahen dhe zgjidhen hallet e tyre.

7. Sepse ky vend ka nevojë për shpresë për një rilindje të vërtetë dhe se duhet kufizuar oreksi i madh i LSI-së

Homazh për Islam Feron



Diana Mile: "Një hap i madh për të kapur kohën e humbur, me dinjitet, përsosmëri në Bashkinë e madhe të Pogradecit"

KAPRI: "BESOJ TEK FITORJA, TE BESA E BASHKËQYTETARËVE"

"... Pogradeci do të zgjedhë djalin e vet, ekonomistin dhe menaxherin e suksesshëm dhe padyshim njeriun që është vetvete dhe që nuk varet prej askujt, por veçse tek obligimi për të bërë detyrën siç duhet. Prapa meje nuk fshihet askush, prapa meje është vetëm eksperiencia ime, përkrah meje është çdo banor dhe para nesh është një e nesërme që do e bëjmë më të mirë..."

Me mokrarrët e Durrësit

Nga Istref HAXHILLARI

Kur i telefonova Ilir Blacërit për t'i thënë se kryesia e Shoqatës Mokrare "Pelioni" kishte vendosur të themelonte në Durrës degën e saj me mokrarrët që banonin aty, m'u përgjigj se ishin gati prej kohësh. Pasi lamë datën dhe orën e takimit mendova se do të mblidheshin nja dhjetë veta. Kjo për dy arsye. E para se mendoja që në Durrës nuk do të kishte shumë mokrarrë dhe



Koloneli i sapodalë nga burgu

Nga Miltiadh DAVIDHI

.....
NËPËR FAQET E
HISTORISË MOKRARE
Jolla me historinë e saj shekullore

Nga Hysni JOLLA

INTERVISTË ME KANDIDATIN PËR KRYEBASHKIAK TË POGRADECIT, ALEANCA "PUNË DHE DINJITET"

Kapri: "Besoj tek fitorja, te besa e bashkëqytetarëve"

Mina HYSA

Pogradeci më 21 qershor do të ketë kryebashkiak një nga administratorët më të mirë të qytetit. Qytetarët e 8 një-sive administrative me ndarjen aktuale do t'i besojnë votën për drejtimin e bashkisë së madhe z. Eduart Kapri. Secili ka plot arsye për të votuar z. Kapri. E para është se në kaq shumë vite besimi i tyre nga të zgjedhurit vendor në qytet dhe komuna është shpërdoruar, nuk është justifikuar aspak dhe pse ndër vite është votuar kryesisht në të njëjtin kah politik në zgjedhje vendore. Kësaj here pritet të vij ndryshimi i madh në një njësi të madhe siç është bashkia Pogradec, po përmes votës qytetare. Të gjithë besojnë tek kalkulimi i hollë prej ekonomisti i z. Kapri, se do të sjell ndryshimin dhe zhvillimin e shumëpritur për Pogradecin, cilësi të cilat ai ka treguar deri më tani në përditshmërinë e tij. Eduart Kapri, 45-vjeç vjen një familje e njohur qytetase. Ai është djali i vogël i Qemalit dhe Fetijes, dy prindër të respektuar në qytetin e Pogradecit që dhanë gjithçka për shkollimin e 5 fëmijëve të tyre. Rrjedh nga një derë e njohur patriote e zonës së Mokrës e cila ka dhënë shumë për krahinën përgjatë momenteve më të vështira të saj. Me përfundimin e studimeve, ashtu si shumë të rinj të brezit të tij, edhe Eduarti provoi jetën e vështirë të emigracionit. Ai jetoi dhe punoi për 5 vite në perëndim, në Gjermani ku punoi dhe drejtoi edhe një biznes shërbimesh. Në vitin 1998, u kthye në Shqipëri ku nisi të punojë në administratën publike si ekonomist deri në vitin 2003. Duke besuar tek iniciativa private dhe zotësitë e tij në biznes, nisi të menaxhojë në kompani private. Prej vitesh ka drejtuar kompani të suksesshme në tregti dhe ndërtim duke dhënë një kontribut për ekonominë e qytetit e duke punësuar me dhjetëra qytetarë pogradecarë. Përfshirja e tij në politikë ka nisur herët, kur vetëm 30 vjeç konkurroi denjësisht një garë që mbahet mend për deputet në zonën e Mokrës në sistemin maxhoritar në vitin 2001. Falë cilësive të tij, Eduarti u votëbesua nga qytetarët e Pogradecit në Këshillin Bashkiak dhe që nga viti 2011 ka shërbyer si Kryetar i Këshillit Bashkiak. Në krye të Këshillit, Eduarti ka një kontribut në nxitjen e mjaft projekteve në qytet si dhe ka treguar se i shërbën interesit qytetar.

Ka treguar cilësi si menaxher në biznes dhe politikan duke punuar me parimin që çdo punë kërkon njeriun e duhur.

Eduart Kapri ka dëshmuar se merr përgjegjësi dhe di t'i çojë ato deri në fund. Familja, komunikimi i hapur me njerëzit dhe serioziteti janë cilësitë e Eduartit dhe një garanci për sukses në drejtimin e Bashkisë së Pogradecit.

Eksperienca e tij e vyer në menaxhim dhe në njohjen e prob-

"... Pogradeci do të zgjedhë djalin e vet, ekonomistin dhe menaxherin e suksesshëm dhe padyshim njeriun që është vetvete dhe që nuk varet prej askujt, por veçse tek obligimi për të bërë detyrën siç duhet. Prapa meje nuk fshihet askush, prapa meje është vetëm eksperiencia ime, përkrah meje është çdo banor dhe para nesh është një e nesërme që do e bëjmë më të mirë..."



leme të Pogradecit u vlerësuan nga Partia Demokratike e cila i besoi kandidimin për kryetar të Bashkisë së Pogradecit. Motoja e tij në këtë fushatë është qytetari pogradecar, nga qyteti në fshat, hallet dhe problemet e tij. Bashkë me ekipin e tij, ai angazhohet për punë dhe mirëqenie. Sfidat e tij është edhe ajo e qytetarëve pogradecarë, kthimi i shpresës. Eduarti është zotuar se dera e tij si kryetar i ardhshëm Bashkie do të jetë e hapur për të gjithë bashkëqytetarët e tij.

Në një intervistë z. Kapri flet si e priti kandidimin, për zhvillimet në qytetin e tij veçanërisht dy vitet e fundit, për mbështetjen e dhënë nga qeveria Berisha Pogradecit me financime dhe mungesën e vëmendjes nga qeveria aktuale, i përgjigjet pyetjes: Sa të zgjedhurit vendor në Pogradec e kanë merituar deri më tani besimin qytetar, si dhe numëron problemet me të cilat përballen sot banorët e Pogradecit. Në vijim të intervistës së tij z. Kapri komenton qeverisjen Rama, thotë përse kërkon të mandatohet nga bashkëqytetarët, si dhe numëron angazhimet në rast se do t'i besohet posti i kryebashkiakut. Ai beson në fitore, komenton kundërshtarin si dhe ka një mesazh për zgjedhësit. Ja si shprehet më tej ai.

Zoti Kapri si e pritet besimin e strukturave të degës, të kryesisë së

PDSH-së dhe kryetarit Basha për të kandiduar për kreun e bashkisë së Pogradecit?

Dua të nënvizoj se vendimi i strukturave të cilat i falënderoj, u mbështet dhe u bazua edhe në një besim më të gjerë social, ishin disa grupe komunitare interesi që mbështetën emrin tim si kandidat dhe e mundshme dhe e përshtatshme. Kjo, ishte sigurisht edhe shtysë pozitive që strukturat dhe kryetari z. Basha të më besojnë kandidimin.

Pa më të voglin dyshim që është vlerësim maksimal, që mes dhjetëra intelektualëve pogradecarë dhe individësh të aftë, strukturat dhe grupet e interesit përzgjedhën emrin tim.

Si do ta lexonit ju këtë besim ndaj jush?

Besimi në të tilla përzgjedhje, apo vendimmarrje përkthehet apo transkriptohet në obligim ndaj vendimmarrësve, obligim kryesisht ndaj banorëve të Pogradecit nga Mokra e thellë deri tek brigjet e liqenit, obligim për të transformuar Pogradecin dhe për të përmirësuar jetën e banorëve. Pogradeci është një perlë e natyrës shqiptare, por që për dekada me radhë e ka përpirë dhe drobitur varfëria, pa frikë do të thoja, në disa zona skamja, varfëria ekstreme. Obligim dhe vetëm obligim, kështu e lexoj besimin ndaj meje.

Ju jeni një person që keni një raport miqësor me bashkëqytetarët e tuaj dhe këtë e keni treguar në çdo rast që iu është dhënë. A kanë qenë zhvillimet e arritura në Pogradec këto vite e sidomos 2 vitet e fundit në lartësinë e pritshmërive të bashkëqytetarëve tuaj?

Me qytetarët përveç se raporte miqësore, me një pjesë të madhe të tyre kam edhe raporte korrekte pune dhe bashkëpunimi. Me një pjesë të madhe të pogradecarëve kam punuar si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Dhe kjo më jep avantazhin maksimal që buron nga faktori "njohje", njerëz që më njohin, njerëzit më dinë, kanë qenë me mua për afro 25 vjet dhe dinë mjaft mirë si dhe çfarë mund të bëj.

I mëshoj këtij fakti, që njerëzit më njohin, më dinë, ndaj dhe më pranojnë kudo shkoj, në çdo cep të Bashkisë së madhe të Pogradecit.

Në këto dy vjet në Pogradec nuk ka zhvillime, për rrjedhojë nuk ka arritje. Në këto dy vjet, për të mos kaluar në doza pesimizmi, duke thënë se në Pogradec ka regres, po ju them me bindje të plotë se ka staniacion të ekonomisë, ulje të nivelit të jetesës dhe shtim të papunësisë.

Për rrjedhojë, situata e sotme në Pogradec jo vetëm që nuk është në nivelin e pritshmërive që kishin qytetarët para dy vitesh, por ka devijuar në kahun e kundërt të boshtit

të zhvillimit, situata është në rënie, me dobësi të theksuara qeverisjeje dhe menaxhimi, në të dy nivelet qeverisës, në atë qendror dhe në atë vendor.

Po t'ju analizoj si ekonomist nivelin apo situatën ekonomike në Pogradec, pamja është gri, gri e thellë që sa vjen dhe errësohet. Po ta analizoj thjesht si qytetar, apo banor i zonave të thella, do u thosha se kudo varfëria është ulur këmbëkryq. U premtuan taksa "zero" për biznesin e vogël, por... U premtuan dhe u thanë shumë "falas", por asgjë nuk është falas, përkundrazi është shumë e shtrenjtë, e kushtueshme në kohë dhe në kosto. Megjithëse në tregun e sotëm ekonomik, fjala "falas" është jashtë fjalorit ekonomik. Mund të flasim për ulje të kostove, ulje të taksave, apo përmirësim të shërbimeve, por çdo gjë e ka një vlerë dhe ky term mbetet thjesht një efekt elektoral, që disa e përdorin dikur për të marrë votë qytetare, por që sot do u kthehet në ndëshkim nga populli. Populli, shpesh beson, ka dëshirë të provojë, por kurrsesi, populli nuk luan me fatet e tij.

Po ju analizoj qeverisjen vendore në Pogradec gjatë këtyre dy viteve. Jo më larg se një vit, të gjithë e mbajmë mend sesi biznesi i Pogradecit u ngrit në këmbë për të kundërshtuar rritjen e taksave nga Bashkia e Pogradecit. Nga një anë premtimet ishin për heqje taksash, nga ana tjetër, Bashkia ngrite në nivele marramendëse taksat vendore. Biznesi reagoi dhe reagoi fuqishëm. Moment ky për t'u ndalur: i njëjti biznes që i dha votën premtimit "falas", i rikthehem gjykimit të popullit. Është i mençur populli.

Kam qenë Kryetar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec dhe jo vetëm që e kam kundërshtuar këtë vendim të Bashkisë, por kam qenë tërësisht kundër këtij vendimi anti-biznes. Është shumë e rëndësishme që pushteti vendor dhe qeveria të kuptojnë se duhet t'i japin frymë hapësirës sipërmarrëse dhe se biznesin duhet ta kenë partner dhe jo "bankomat".

Ja, këto janë pak a shumë "zhvillimet" në Pogradec, sigurisht nuk ka asnjë ndërhyrje në infrastrukturë, veçse 18 kilometrave, veper e filluar nga qeveria e djathtë, që po kthehen në 18 kilometrat e barrierës së turistëve dhe vizitorëve vendas, që për shkak të rrugës nuk vijnë më në Pogradec. Janë edhe 18 kilometrat e disa dhjetëra bizneseve të prishura dhe disa qindra njerëzve sikur në punë, sot të papunë. Janë 18 kilometrat, që sjellin tashmë më pak të ardhurave për sigurimet shoqërore, për pak të ardhura për zyrën e tatimeve, miliona lekë të ardhura më pak për doganat, më pak të ardhura për pushtetin vendor, qindra milionë lekë më pak në tregun e Pogradecit, qindra milionë lekë më pak në tregun e konsumit.

A mund të konfirmimi sa projekte ka mbështetur me financim qeveria Berisha në Pogradec dhe sa projekte ka mbështetur

qeveria Rama?

Nuk di nëse mund të bëhet krahasim mes ekzistentes dhe inekzistentes. Kësaj pyetje i japin më mirë përgjigje pogradecarët. Si qytetar, apo si banor, nuk di që të ketë ndonjë investim nga Qeveria aktuale në Pogradec. Kjo qeveria e ka thënë që nuk ka dëshirë që t'i ngelen rrugët rrugëve, mesa duket ka vendosur që të lërë njerëzit rrugëve.

Sa për investimet dhe projektet e periudhës 2005-2013, ato janë të shumta në numër dhe me impakt direkt në jetën e banorëve. Rrugë nacionale dhe dytësore, impianti i ujërave të zeza në Pogradec, sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza, sistemi i ujit të pijshëm në qytet dhe në shumë fshatra, rikonstrukcione shkollash dhe qendrash shëndetësore, subvencione për fermerët etj., që sigurisht i dhanë shtysë ekonomive lokale. Sigurisht një vepër madhore e qeverisë së kaluar ishte aprovimi dhe sigurimi i fondit për ndërtimin e rrugës Qukës – Qafë Plloçë që do i japë zonës së Mokrës mundësinë e zhvillimit real, duke e nxjerrë nga izolimi dhe marxhinalizimi ekonomik, ashtu e dhe social.

Sa të zgjedhurit vendor para jush si kryebashkiak të Pogradecit kanë mundur të mbajnë premtimet dhe ta meritojnë besimin e dhënë nga banorët e qytetit tuaj?

Më lejoni të mos komentoj të shkuarën, dhe personazhet e saj. Fytyra e së shkuarës është kjo që hasim sot në qytetin e Pogradecit dhe zonat përreth. Theksoj, qyteti nuk është vetëm një rrugë e asfaltuar buzë liqenit, një fasadë, disa stola dhe disa statuja të vetmuara. Qyteti fillon nga periferia për të shkuar në qendër. Dhe periferia sot është e errët, e papastër, pa rrugë, dhe pa shumë e shumë facilitete që i kanë qytete të përngjashëm në Europë.

Cila janë problemet reale më të cilat përballen sot banorët e zonës nësisë suaj administrative?

Shtrihemi në një zonë gjeografikisht heterogjene, liqenore, kodrinore, malore. Për rrjedhojë, vështirësitë dhe problemet me të cilat hasen banorët janë nga më të ndryshmet, nga më të shumëllojshmet, do të përballemi me një diversitet problemesh ekonomike dhe sociale që ditën e parë në drejtim.

Sigurisht, mbetet problem jetik infrastruktura rrugore, kanalizimet e ujërave të zeza, sistemet e kanaleve ujitëse, vaditëse dhe kulluese, mungesa e tregjeve për shitjen e produkteve bujqësore, prezenca e industrisë përpunuese mungon, uji i pijshëm në zona me dendësi më të madhe demografike, mungesa e qendrave shëndetësore, mungesa e çerdheve, kopshteve me dreqë, mungesa e transportit publik, e shumë e shumë të tjera probleme, por që me vullnet nga Pushteti lokal, mund të gjejnë zgjidhje, mes investimesh publike dhe private.

Boshti i punës sime në Bashki do të jetë Partneriteti Publik – Privat, mbi këtë binom do e ndërtoj më punën në Bashki dhe jam i bindur për suksesin, tërësisht i bindur.

Si ju duket qeverisja e deritanishme e Ramës e parë në aspektin e qenies së ekzekutivit pranë qytetarit?

Pro, kundër dhe abstenim, janë tre alternativa. Kjo qeverisje nuk është "pro" qytetarit. Në të shumtën e rasteve është "abstenim", në disa qindra raste ka qenë dhe është "kundër" qytetarit.

Përse kërkoni të mandatoheni nga qytetarët tuaj dhe sa besoni të ndryshimi i sjelljes së votës kësaj here?

Rama-Meta s'kanë ofertë, s'kanë zgjidhje prandaj kërcenojnë kandidatet dhe qytetarët

Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha ka vijuar turin elektoral në qytetin e Pogradecit.

Varfëria dhe mjerimi kanë pllakosur anëmbanë vendit, qytetarët kërkojnë zgjidhje, ndërsa dyshja Rama - Meta ofrojnë kërcënime, shantazhe, mallkime. Zoti Basha theksoi se e vetmja gjë që duan Rama - Meta është të fusin në dorë Pogradecin, që ta përdorin për interesa të tyre dhe duke e parë se vullneti i zgjedhësve nuk është në anën e tyre, kërcenojnë kandidatit e opozitës.

Kanë ardhur në këto zgjedhje në Pogradec me një pazar të ulët që ka një dhe vetëm një qëllim, kapjen e Pogradecit, kthimin e Pogradecit në një çiflig për Ilir Metën e LSI, përdorimin e pushtetit vendor për korrupsion e abuzivizëm. Kjo është arsyeja se pse Ilir Meta e do me çdo kusht Pogradecin dhe nuk ka ndalur as para shantazheve, as para kërcënimeve për të bërë gjithçka që ta shtijë në dorë. Së fundmi, guxoi dhe kërcënoi edhe kandidatit tonë. Po pse e kërcënoi, thoni ju? Sepse nuk ka alternativë, s'ka ofertë, s'ka zgjidhje për problemet e Pogradecit dhe pogradecarëve dhe e ka kuptuar. Ai e di që pogradecarët e dinë se Ilir Meta nuk është zgjidhja por është problemi për Pogradecin.

E dinë të djathtë, e dinë të majtë, e dinë demokratët, e dinë socialistët. E dinë të gjithë, sepse si asnjëherë tjetër Pogradeci do të votojë për ofertën e vërtetë dhe njeriun e vërtetë të punës dhe përkushtimit ndaj jush, për Eduard Kaprin, ndaj do me çdo kusht që të mos ketë garë, do me çdo kusht të mos ketë zgjedhje sepse e di që me zgjedhje i fituari është i zgjedhuri i Pogradecit dhe pogradecarëve, kryetari i ardhshëm i Bashkisë, Eduard Kapri"

Këta erdhën në pushtet, - tha zoti Basha, sepse premtuan uljen e taksave por në fakt çfarë bënë? I rritën ato, rritën taksën mbi naf-tën me 240 lekë për litër dhe ia transmetuan këtë rritje të gjithë mallrave dhe shërbimeve për të gjithë shqiptarët, rritën taksën mbi pronën duke gërmuar edhe më thellë në xhepat e boshatisur të familjarëve.

"Këta premtuan 300 mijë vende pune por papunësia është rritur, varfëria është rritur, varfëria ekstreme është pesëfishuar, sipas të dhënave të vetë qeverisë.

Këta premtuan çmime të ulëta por çmimet e ushqimeve janë rritur, çmimi i energjisë është bërë i papërballueshëm, njerëzit po shesin orënditë, fermerët po shesin bagëtinë e prapë nuk ia dalin.

Nuk kërkoj një mandatim në njëjës, si i vetëm. Ne jemi një popull i tërë që duam të qeverisemi ndryshe dhe që vetë do e sjellim ndryshimin, fillimisht mes votës dhe më pas mes aktivitetit tonë të përditshëm.

Dikush do të jetë kreu i zgjedhur, por Bashkia është një organizëm i gjallë me shumë e shumë qeliza në funksion të së tërës, ku gjithsecili është po aq i domosdoshëm sa edhe grezua.

Cilat do të jenë angazhimet tuaja si kryebashkiak. Nga do ta nisni punën ditën e parë si i mandatuar pas 21 qershorit në rast se do të merrnin besimin e bashkëqytetarëve tuaj?

Ditën e parë do të hartëzojmë një kalendar prej 1460 ditësh, plani do të jetë 4-vjeçar dhe jo i copëtuar në një vit plan. Mbi këto 1460 hoje



Njerëzit po zhyten në borxhe, familjarë, kryefamiljarë që arrijnë deri sa të shesin gjakun e trupit për të mos përfunduar pas hekurave, për 30 apo 40 mijë lekë të vjetra borxh të papaguara.

Kush ka një vend pune është i pasigurt nëse do e mbajë apo jo, mijëra e mijëra të tjerë kanë humbur vendet e punës dhe s'kanë asnjë siguri se të gjejnë vend pune. Pamundësia për të mbyllur muajin është makthi më i madh i mbi 80% të familjeve shqiptare, kryefamiljarë e kryefamiljare që rrinë me sytë nga qielli apo me sytë përdhe sepse nuk kanë se me çfarë të ble-

(ditë) do të fillojmë "mbushjen".

Por, fillimisht, që do u bëj me dije ditën e parë të gjithë punonjësve të Bashkisë, se puna e parë, është hartimi i Master Planit Urban – Mjedisor (Plani i Rregullimit të Territorit) të Bashkisë Pogradec. Ky plan do të jetë fondamenti, mbi këtë do të mbështetemi, për të hartuar plane afatgjata që i rezistojnë kohës dhe që reduktojnë koston në sektorë jetikë të zhvillimit socio-ekonomik: infrastrukturë, turizëm, bujqësi, blegtori, agrobiznes etj., mbi këtë plan do të shtrihen 1460 ditët (hojet) e punës.

Sa besoni në fitoren tuaj dhe nëse po cilat mendoni se janë anët tuaj më të forta?

Besoj në mënyrë absolute tek fitorja, jam i bindur për këtë dhe do e tregojë data 21 qershor. Ana

imë e fortë është fakti që nuk kam anë të dobët. Si ekonomist që jam dhe si menaxher, besoj i suksesshëm i aktivitetit tim sipërmarrës, kam shtrirë filozofinë time qeverisëse në boshtin e Partneritetit Publik-Privat. Mbi këtë linjë do të sjell pranë dhe në ndërveprim Bashkinë me Sektorin privat, me objektiv final thithjen e investimeve. Partneriteti, kjo është pika e fortë.

Si e konsideroni kundërshtarin tuaj?

Kundërshtarja ime nuk është kundërshtarë, është një pogradecarë, që dikur unë e kam mbështetur në hapat e saj të parë, në profesionin e saj, siç mund të bëjë një sipërmarrës me shumë e shumë të rinj që duan të hyjnë në tregun e punës, paçka se sot, kandidatja e LSI, deklaroi se "nuk më njeh".

Nuk kam kundërshtar në këtë kandidim. Në këtë kandidim jam në garë me veten.

Mesazhi juaj për zgjedhësit?

Pogradeci nuk ka nevojë për mesazhe të gjata, për thirrje të bujshme. Pogradeci do të zgjedhë djalin e vet, ekonomistin dhe menaxherin e suksesshëm dhe padyshim njeriun që është vetvete dhe që nuk varet prej askujt, por veçse tek obligimi për të bërë detyrën siç duhet. Prapa meje nuk fshihet askush, prapa meje është vetëm eksperiencia ime, përkrah meje është çdo banor dhe para nesh është një e nesërme që do e bëjmë më të mirë.

Shtrati i Fjalës sime është e vërteta! Shtrati i Besimit në Fitore është populli i mençur dhe punëdashës i Pogradecit!

didatëve tanë" - theksoi zoti Basha

Ditë për ditë, theksoi kryetari i Partisë Demokratike merren vetëm me mashtrime, fjalë boshe sepse nuk kanë interes tjetër përveç kontrollit e pushtetit absolut, nuk kanë asnjë interes për zgjidhjen e problemeve tuaja. Interesi i vetëm që kanë është pushteti i tyre, ndaj gjërat kanë shkuar keq e më keq sepse nuk kanë parë për asnjë moment se çfarë mund të bëjnë për ju.

"Çështja që shtrohet në këto zgjedhje është, a është ky drejtimi i duhur për ju? A janë taksat e larta, rrogat e ulëta, papunësia, çmimet që rriten, faturat që dyfishohen? A është ky, drejtimi i duhur për ju? A është ky drejtimi i duhur për të djathtë, a është ky drejtimi i duhur për të majtë? Sigurisht që jo, por për ta ky është drejtimi i duhur, ndaj kanë bërë gati të rrisin edhe çmimin e ujit me 50%!

Votoni ofertën tonë për të ulur taksat, që më shumë para të jenë në xhepat tuaja, më shumë para të jenë te biznesi që të punësojë më shumë pogradecarë, rini, t'i punësojë e t'i punësojë me paga dinjitoze. Votoni platformën tonë për uljen me 25 % të çmimit të energjisë, më të lartë në rajon. Votoni platformën tonë për heqjen e taksës prej 240 lekë/litër për karburant, në mënyrë që edhe këtu karburanti të mund të tregtohet njësoj siç tregtohet në anën tjetër të kufirit, që shqiptarët, njerëzit me të ardhura më të ulëta të mos e paguajnë karburantin më shtrenjtë se çdo popull tjetër i Ballkanit!

Çdo votë e juaja do të jetë një përgjegjësi e madhe për Partinë Demokratike dhe për mua Lulzim Bashën, që t'ju përgjigjem me vendosmërinë time e të opozitës, çdo orë e çdo minutë deri në fitoren e betejës tonë për taksat të ulëta, për çmime të ulëta, për punë dhe dinjitet!

Ora e fitores po afron, ora e zmbarsjes së zullumit dhe oligarkisë po afron, asgjë nuk e ndalon, asgjë nuk na krenbri!" - përfundoi fjalën e tij, kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha.

PORTRET ELEKTORAL

DIANA MILE

"Një hap i madh për të kapur kohën e humbur, me dinjitet, përsosmëri në Bashkinë e madhe të Pogradecit"

Nga Dhimitër Gegprifti

Është hera e dytë që në këto shtatë dekada e gjysmë konkurren një grua, një zonjë për të qenë qytetarja e parë e qytetit të Pogradecit, kryetare e Bashkisë së re, pas reformës administrative-teritoriale dhe kjo është Diana Mile, arkitekte në profesion, por synon të jetë arkitekte me një vizion të ri, gjithëpërfshirës për të gjithë jetën dhe zhvillimin e kësaj Bashkie pas 21 qershorit 2015. Kandidatet e koalicionit: "Aleanca për Shqipërinë Europiane" me moton: "Drejtimi i duhur".

PASAPORT...

"Është në moshën e energjive për të punuar, vendlindja e saj është Pogradeci. Është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës. Prej vitit 2013 është administratore në "Dandelion", sh.p.k Pogradec si dhe drejtore e "Sh-tëpia e gjelbër", NGO. Aktualisht ushron profesionin e saj si arkitekte dhe është drejtuese e planit urbanistik në Pogradec. Më i njohuri ndër projektet e zonjës Diana Mile, është projekti i ri i jetësimit të fshatit Tushemisht.

Nga një zonë, pothuajse e pavizituar, e izoluar, që bënin përpjekje maksimale për të qenë destinacion turistik, tani është kthyer përfundimisht si i tillë.

Është pedagoge e jashtme në degën e Arkitekturës në Universitetin Politeknik të Tiranës.

NJË VIZION I RI PËR QYTETIN E LINDJES...

Jam shumë e vlerësuar që më kanë besuar garën e Bashkisë së Pogradecit. Tashmë emri im nuk mbetet më një propozim, por për mua është kthyer në një detyrim, ndaj të gjithë anëtarëve dhe simpatizantëve të LSI-së në të gjithë zonën administrative të Pogradecit, një detyrim për një fushatë të denjë dhe pa probleme.

ZONA ADMINISTRATIVE, JETA, PRIORITETET PAS 21 QERSHORIT...

Pogradeci është një qytet turistik, që të fal kënaqësi. Këtu ka vlera, jo vetëm natyrore, por edhe kulturore, të cilat meritojnë vëmendje. Liqeni, që na rrethon nuk na fal vetëm bukurinë, por për këtë liqen do të investohet, që edhe nga ai të vijnë të ardhura, kështu krijohen më shumë mundësi punësimi për vendasit dhe më shumë mundësi tërheqje për turistët. Shumë impemjim do të kenë edhe zonat rurale dhe fokusi, që do të ketë Bashkia do të jetë dhe më i gjerë, duke përfshirë më shumë veprimtari në fushën e bujqësisë dhe pentarisë.

Ky dimension i ri administrativ do të sjellë më shumë punë dhe para në të gjithë Pogradecin. E gjithë vija e liqenit, por edhe zona malore, shumë e izoluar e Mokrës do të jenë pjesë e Bashkisë së re.



Tashmë qyteti i Pogradecit është futur në një transformim rrënjësor për t'i dhënë një mundësi më të mirë jetese të gjithë banorëve. Projektet, që tashmë janë në zhvillim e sipër, janë ata, që lidhen me ndërtimin e unazës së Pogradecit, rikonstruksioni i rrugës Lin-Pogradec, që është drejt përfundimit. Nënshkrimi i kontratës për fillimin e punës për rrugën Qafë-Plloçë-Qukës, do të çeli më shumë mundësi për Mokrën dhe Mokrarët.

HAPËSIRAT E REJA, RESURSET DHE MENAXHIMI I BUXHETIT...

Pogradeci tashmë është shtuar. Me Reformën Administrative janë rritur përgjegjësitë për çdo fshat, çdo rrethinë, çdo lagje. Tani të gjitha problematikat apo dhe risitë do të duhen të finalizohen nga kryetari i Bashkisë. Në këtë situatë Qeverisjen Vendore e shoh të fokusuar në rëndësinë, që duhet t'u japë resurseve aktuale, ku çdo njësi apo zonë rurale spikat.

Buxheti do të menaxhohet me nikoqirllëk të madh, veçanërisht zonat malore, ku investimet kanë qenë të pakta. Pa dyshim zona e Mokrës do të jetë prioritet në punën time. Bashkia aktuale ka pasur performancën e saj mes suksesit dhe përpjekjes së një qeverisje të mirë. Sigurisht të mirat nuk vijnë menjëherë.

Qenia ime në krye të saj do të jetë një hap i madh për të kapur kohën e humbur me dinjitet dhe përsosmëri në të gjithë Bashkinë e madhe të Pogradecit.

...Unë për një gjë jam e sigurt: këto javë e në vijim po takoj e vizitoj gjithë Pogradecin, po njihem me hallet dhe problemet, që duhet t'i zgjidhim së bashku.



Si një zonjë e një shtëpie të madhe, do të përkujdesem pa dallim për të gjithë. Populli thotë: Dielli që është diell dhe nuk i ngroh të gjithë, por unë do të jem në lartësi të detyrës së Kryebashkiakes për t'i parë të gjitha pa anësi. Dielli i kohës për Pogradecin nën drejtimin tim, do të jetë më i ngrohtë, më optimist që në lndje të tij. Punët e mira nisin herët që në mëngjes.

PROGRAMI NË DORË TË ELEKTORATIT, TRANSPARENCA...

Bashkë me stafin tim, specialistë të fushave të ndryshme, intelektualë të zotë, kam hartuar programin me të gjitha detajet, i cili është në dorë të votuesve. Për realizimin e tij, ndër të tjera, do të publikohet në një botim të përtremuajshëm, që do të dalë për banorët e kësaj Bashkie. Ky oaz mediatic do të jetë, jo vetëm zëri i Bashkisë së madhe, por edhe zëri i gjithë pogradecarëve pa dallim. Këtë projekt ende e kam ide në

mendjen time. Sapo të filloj detyrën e kryebashkiakes, ky botim do të jetë një mundësi më tepër për informim dhe mirëqeverisje së bashku.

FUSHATA JO PROCES ANKTHI APO DIKTATI, POR KËNAQËSI DHE PËRVOJË E BUKUR...

Nga takimet, që kemi zhvilluar dhe në vazhdim me njëritjetrin, të gjithë organizatorët LSI dhe Socialistë kemi kërkuar një fushatë të tillë. Në këto ditë pas shpalljes së emrit tim, gjithë LSI-ja dhe PS-ja janë mobilizuar për fitoren time më 21 qershor 2015. I ftoj të gjithë të votojnë një arkitekte, specialiste të kësaj fushe, që e di mirë, ku i pikon çatia e halleve dhe problemeve tona. Argumenti im është ndershmëria në detyrë për të drejtuar Pogradecin e madh, ndershmëria, që, siç thotë Fan Noli, mbetet politika më e mirë në drejtim. Le ta zbulojmë bashkë axhendën e ditës sime të parë të fitores dhe të punës!



INAGURIMI I SHKOLLËS SË MESME TË BASHKUAR "SKËNDER DURBAKU" RODOKAL SIPËR

Inagurimi i shkollës "Skënder Durbaku" të Rodokalit më datë 02/05/2015 shënoi finalizimin e shumë përpjekjeve për të patur një shkollë ashtu siç e kemi merituar, një shkollë që duhet për të zhvilluar një mësim në kushte normale.

Edhe këtë herë nuk munguan aktivitetet me këtë rast të veçantë, ku në mes të tjerash u përgatit një koncert më së shumti me këngë e valle nga nxënësit e shkollës "Skënder Durbaku" Rodokal Sipër.

U vlerësua kontributi i çmuar i kryetarit të komunës Z/ Fuat Fero, ish-drejtorit të shkollës Z/ Hyqmet Kolgega si dhe këshillit të komunës me kryetar Z/ Përparim Hidri të cilët me vendim unanim mbas kërkesave të vazhdueshme nga të tre kryesitë e fshatrave që mbulon kjo shkollë morën vendimin për mbylljen e ish-godinës ku zhvillohej mësim për shkak të kushteve shumë të vështira të mësimdhënies dhe rrezikut evident ndaj nxënësve që kalonin gjysmën e ditës në një godinë e cila rrezikohet seriozisht të shembet. Një rrugë e gjatë përpjekjesh dhe vështirësish që nga dita kur u hodh themeli i shkollës së re dhe deri në sistemimin e shkollës me mjetet e duhura për zhvillimin e një ore mësimore normale.

Të ftuar ishin edhe përfaqësues zyrtarë si deputeti i zonës Z/ Ilir Xhakolli, drejtori i zyrës arsimore Pogradec Z/ Ilir Torra, kandidatja për bashkinë Pogradec Znj/Diana Mile etj, të cilët në fjalën e tyre vlerësuan maksimalisht përpjekjet e komunitetit në radhë të parë dhe kryetarit të komunës si përfaqësues lokal i tyre në ndërtimin e kësaj shkolle.

Koncerti i organizuar nga nxënësit u hap me himnin e flamurit për të cilin të gjithë u ngritën në këmbë dhe vazhdoi me recitimet dhe më së shumti këngë e valle që i përkisnin folklorit të zonës tonë.

Momenti kulmor i asaj dite ishte prerja e shiritit të inagurimit të shkollës nga Z/Fuat Fero dhe drejtuesha e shkollës Znj/Kadrie Bufi i cili u shoqërua me duartrokite nga banorët e shumtë të mbledhur në këtë ditë. Më pas përfaqësuesit zyrtarë dhe banorët të fshatit hynë në shkollë për të parë ambientet e reja të shkollës. Në ambientet e shkollës u vu re që mungonin shumë mjete didaktike dhe mësimore për të cilat na u premtua se me fillimin e vitit të ri mësimor do të realizohen.

Me mokrarët e Durrësit

Istref HAXHILLARI

Kur i telefonova Ilir Blacërit për t'i thënë se kryesia e Shoqatës Mokrare "Pelioni" kishte vendosur të themelonte në Durrës degën e saj me mokrarët që banonin aty, m'u përgjigj se ishin gati prej kohësh. Pasi lamë datën dhe orën e takimit mendova se do të mblidheshin një dhjetë veta. Kjo për dy arsye. E para se mendoja që në Durrës nuk do të kishte shumë mokrarë dhe e dyta se Iliri nuk do të mund të lidhej me ata që banonin larg zonës së tij. Me këtë mendje udhëtova drejt Durrësit një ditë të nxehtë në fund të muajit maj. Kishim lënë orën gashë pasdite për takimin meqë ata punonin, nuk e kishin të lehtë grumbullimin. Bashkë me mikun tim, poetin Eduart Sulollari nga Pogradeci, morëm pjesë atë ditë në punimet e "Pranverës poetike durrsake" organizuar nga klubi i shkrimtarëve të Durrësit. Në mbrëmje pritëm te Rrota e Kuqe, stacion autobusësh pranë hekurudhës.

Ilir zbriti nga makina na përqafoi dhe më pyeti:

- E njeh shoferin?

Pashë të vinte drejt meje një fytyrë e njohur që s'po e sillja ndër mend.

- Jam Agron Xhyra, Profesor, - m'u drejtua buzëqeshur ish nxënësi im i shkëlqyer i

Shkollës së Mesme Trebinjë para tridhjetë vjetësh. Mësuesi i fizikës, pasi punoi disa vite në shkollë të ndryshme të Durrësit ishte pozicionuar së fundi në Qendrën Kulturorë të fëmijëve durrsakë, pozicion i lakmuar edhe për vendasit. Mokrari ynë e kishte fituar me zotësi detyrën.

Udhëtimi me makinën e Agronit na u duk i gjatë nga që vendtakimi ishte në anën të tjetër të qytetit. Zbritëm pranë një lokali të ri, ende në ndërtim e sipër. Mendova se do të ishte i ndonjë durrsaku të vjetër, kur më thanë se pronari që nga Velçani. I biri, një djalë i ri simpatik na priti me respekt.

Fillimisht u ulëm në tavolinat jashtë, po shumë shpejt karriget nuk sosën dhe u detyruam të hyjmë brenda. Mokrarët e Durrësit vinin një nga një. Sido që jo të gjithë më njihnin, më takonin me mall, a thua u kisha sjellë gjer atje një copë toke nga fshati i tyre apo dheu i Mokrës. Dhe mua të gjithë më ishin të njohur, më bëhej se diku i kisha parë. Mokrarët dallojnë prej të tjerëve, janë më të sjellshëm e kokulur, kanë fytyra të fisme.

Të gjithë kishin mall për



viset nga qenë larguar, njerëzit që jetonin në fshatrat e tyre. Biseda u soll rreth të njohurve të hershëm që kishin vite pa i parë. Emra njerëzish, vendesh, ngjarjesh të shkuara fluturonin përmbi tavolinën e zgatur qosh më qosh lokalit mokrar aty në qendër të Durrësit plak.

Flasin me radhë e sërë, ashtu siç dinë t'i bëjnë kuvendet mokrarët. Të ë respektueshëm e seriozë e shikojnë njëri-tjetrin me dashuri e përgjërime.

U fola shkurt për misionin tim, informova për Shoqatën mokrare të themeluar pesëmbëdhjetë vjet më parë nga iniciatorët tashmë emblematikë, Haki Balliu e Flori Slatina dhe të tjerët Zenun Fero, Zabi Çuku, Pëllumb Zade, Ramadan Kllogjri, Hariz Durbaku, Izja Xhika etj. U thashë se gazeta "Mokra" mbushi shifrën prej 200 numrash në pesëmbëdhjetë vite dhe vazhdon të dalë rregullisht çdo muaj si një nga gazetatat lokale më të vlerësuara në Shqipëri.

U ndala më gjatë në misionin tim të asaj dite.

Nëpër rrjedhat e kohës, Mokra dhe mokrarët, krenarë

e të përfillur, punëtorë e të besës, të mençur e shakaxhinj, të gjendur në të mira e të këqija si rrallë të tjerë. Kush vajti e nuk mbeti mahnitur nga përthyerjet dhe bukuritë e pashoqe të vendit e natyrës, nga pritja e ngrohtë që zë fill të shpirti i njeriut, nga ajo dollia e hollë plot nur, e vjetër sa dheu mokrar? Mbi këtë vend të bekuar dora e zotit ka shkundur hire natyrore pa kursim. Nuk ka asnjë grimë të historisë së kombit ku Mokra, krahina e rëndë në juglindje të Shqipërisë, të mos ketë qenë, në mos protagoniste, aktore me role të ndryshme sipas rastit.

Mokra jonë sot nuk ndodhet në ditët e saj më ta mira, po ka qenë një kohë kur ishte zonjë e vërtetë, e respektuar nga të gjithë. Shumë mokrarë

sot janë larguar për jetë më të mirë si një aspiratë e natyrshme e njeriut, po kudo ata mbartin me vete zakonet, traditat, kulturën, mikpritjen dhe burrërinë proverbiale. Ajo që na bashkon ne dhe na ndjell të rrimë bashkë është të qenit mokrar, dheu i mokrës ku janë varret e lashta të të parëve tanë, zakonet e hijshme mokrare që nuk bjerren kudo ku shkojnë për të banuar.

Së fundi u propozova të themelonim atë ditë degën e Durrësit.

E pamundur të sjell këtu gatishmërinë dhe emocionin e atyre burrave. Të gjithë më shikonin me dashur si t'u kisha sjellë një mesazh të madh bashkimi.

- Ne e dinim për Shoqatën e mokrarëve dhe gazetën "Mokra"

- tha Ahmet Proga, - po nuk po gjenim mundësinë e takimit me ju. Jemi këtu mbi dyqind familje mokrare të shpërngulura njëzet vjetët e fundit dhe kur të vish herën tjetër do të gesh këtu jo njëzet e pesë burrë po mbi njëqind burra e gra.

- Në fillim emigrova në Grabian të Lushnjës, - tregoi Shkëlqim Torra, - dhe atje u bëmë aq shumë sa zgjodhëm kryetarin e komunës, pa çka se ai nuk na doli i besës. Ne mokrarët po të duam çojmë tre deputetë në Kuvendin e Shqipërisë.

Ismail Qyrku, djali i Jollës së largët ishte gati të na mbante në krahë.

- Prisnim të vinte dikush, - më tha, - po nuk e mendoja se do të ishte ti, Profesor. Ne ndihemi sot dyfish krenarë, për mokrën që nuk i harron bijtë e vet dhe aktin e formimit të degës së Durrësit që sigurisht do të jetë nga më të mëdhatë e më të fuqishmet.

Folën me radhë Barjam Leka, mësuesi veteran, Jonuz Kamolli i përkushtuar si rrallë tjetër, Shkëlqim Torra, Riza Tato, Ardian Torra, Nevruz Korça, Rrapo Tato etj.

U vendos themelimi i Degës dhe data 30 maj u shpall dita e mokrarëve durrsakë. Çdo 30 maj do të festojnë ditën e themelimit të degës dhe do ta shndërrojnë atë në një ditë feste të përvitshme.

Mbledhja e përgjithshme zgjodhi në kryesi:

- Ilir Blacëri
- Ahmet Proga
- Riza Tato
- Ismail Qyrku
- Vullnet Kasmollari

Kryesia në mbledhjen e parë zgjodhi:

- Ilir Blacëri, kryetar
- Ahmet Proga, nënkryetar
- Ismail Qyrku, sekretar.

Një nga vendimet e rëndësishme ishte abonimi në gazetën "Mokra" me kuotën vjetorë 300 lek të reja në vit.

Në takimin me mokrarët e Durrësit u pi raki, se ajo është pija emblematike e mokrarëve. Për fat të keq, angazhimet e mia letrare të asaj dite nuk më lejuan të çonim deri në fund atë takim të bukur.

Dollia dhe kënga u lanë të bëheshin një ditë tjetër.

Durrës, 30 maj 2015

Kryeredaktor; Flori SLATINA

Zv/kryeredaktor: Ariz DURBAKU

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabit ÇUKU, Pellumb ZADE, Ramadan KLLOGJERI

Istref HAXHILLARI, kryetar i shoqatës "Pelioni"
Zabit Çuku, Bedri MOKRERI, nënkryetarë të shoqatës
Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

NËPËR FAQET E HISTORISË MOKRARE

Jolla me historinë e saj shekullore

Nga Hysni JOLLA

GOJËDHËNAT PËR HISTORINË DHE ORIGJINËN E TYRE.

Stërgjyshërit dhe gjyshërit tanë për Jollën e sotme tregojnë se kanë ardhur në këtë vend, në këtë pjesë të trevës së Mokrës, aty rreth vitit 1830, gati 22 dekada më parë. U vendosën në lagjen Guri i Kuq, ashtu, është quajtur atëhere, se vendi kufizohej nga një kodër me gurë të kuq dhe kalimtarët, që kalonin nga fshatrat Trebinjë, Çezmë, Hondisht, Llëngë, Kukur, Gribë e gjetiu e kishin emëruar kështu, se deri në atë kohë nuk njihej fshat, si qëndër rurale.

Një arsye tjetër ishte se në këtë territor jetonte vetëm një familje, me një zotërim territori deri në fshatin Llëngë, një arsye tjetër, që kjo familje ishte anëtare e fshatit Llëngë. Ky territor i takon Manastirit të Llëngës, por këta banorë të ardhur u regjistruan bujq. Këtë territor ata e morën për ta punuar dhe një pjesë për kullota, ku do të mbarështronin edhe gjënë e gjallë.

Këto familjen janë larguar nga fshati Poroçani i rrethit të Gramshit për arsye hasmërie, ku ishin konfliktuar fisi me fis dhe si pasojë vdekjen e 13 burrave, një nga të cilët ishte nga fisi ynë, të cilin e vranë ata, që erdhën nga Poroçani, për të marrë hakë.

Ai është vrarë afër shtëpisë në vendin e quajtur Burimi i Gurrës, i cili njihet edhe sot. Nga pikëpamja etimologjike duket se i takon një kryqëzimi gjuhësor.

Sot ai vend njihet si vend i shenjtë. Këtë histori të së kaluarës duhet ta mësojnë dhe të mos e harrojnë brezat, të kaluarës e fshatit të yre. Këtë sipërfaqe toke ua dha ish-prifti i Kishës së Manastirit të Shën Marenës. Kjo sipërfaqe kaq e madhe ishte tokë e papunuar, por e mbuluar me pyje: pishë, bredh, ah dhe shkurre. I gjithë ky territor i ngjante një këshqijelle natyrore, që i favorizonte, jo vetëm të jetonin, por edhe për t'u mbrojtur.

GHENEALOGJIA E FISIT JOLLA

I pari i fisit është quajtur Lamçe Jolla me katër vëllezërit e tjerë: Sejdinin, Jonuzin, Nebiun dhe Ramon. Edhe këta me djem e vajza, pra familje të mëdha dhe një fis i gjerë, të cilët filluan të punonin tokën dhe të merren me shumë me blegtori, pasi i favorizonte shumë territori. Familjet e këtij fisi filluan të zmadhoheshin, se lindën djem e vajza. Lamçja kishte tre djem: Isufin, Hametin dhe Hyseinin. Sejdini kishte: Mersinin, Jonuzin, Rakipin, Nebiun, Manen, Zemen, Temen, Shaipin.

Ramoja kishte dy vajza. Këta djem e vajza u rritën dhe filluan të krijojnë familje të reja, kështu numri i familjeve Jolla filloi të rritej.

Isufi, i biri i Lamçes, lindi pesë djem e tri vajza: Filen, Zeren, Rustën, Livanin, Shemen dhe vajza: Këzen, Nazen dhe Begzanen. Hameti, i biri i Nebiut kishte: Zenelin, Mislimin, Pashakon, Sipe e Avezin, Rakipin, Demirin, Nezirin. Rakipi mori edhe nipërit e tij. Nga fshati Kukur, ku kishte mbetur pa përkrahjen e babait, Riza Bega, kurse nëna Merushe, kujdesej për të. Kështu që në këtë fshat ishin vetëm dy fise: Jolla dhe Bega. Karakteristikë e këtyre fiseve ishte se jetonin bashkë, për ta nuk ekzistonte fjala: "ndarje".

EKONOMIA DHE PASURIA E FISEVE, FISIT JOLLA...

Fisi Jolla i shtegtuar nga Poroçani erdhi me një ekonomi të kosiderueshme: 900 krerë dele, 500 krerë dhi, 60 krerë lopë, 20 kafshë samari. Vendosja në këtë territor nuk u jepte mundësi tjetër, veçse të merreshin me blegtori, duke i dhënë asaj prioritet. Me të ardhurat blegtorale bënin tregti. I shisnin ato dhe blinin grurë, misër, veshmbathje. Tregu për ta ishte Struga dhe Ohri. Gratë merreshin me përpunimin e leshit, duke prodhuar shajak me dy dhe katër lisë. Ai me katër lisë përdorej për burrat për xhaketa e pantallo-



na, jelekë, ndërsa tjetri përdorej nga gratë për fustanë, breza, shparge, tërkuzë, çorape e qeleshe, guna dhe velenxa.

Këto i shkonin për shtat klimës, pasi ishte gjashtë muaj dimër dhe gjashtë muaj behar: Shën Gjergj dhe Shën Mitër. Në periudhën e dimrit bagëtitë i shtegtonin në Çërragë e në Dragot të Lushnjës, toka, që i kishin marrë me qira, në stanin e Meterizit, në liqenin e Llëngës dhe Qafën e Gurit.

Numri i bagëtive arriu deri në 2000 krerë, me të cilat shërbenin 12 barinj, qumështarë e barxhakë. Familjet e këtij fisi vazhdonin të rriteshin me një numër anëtarësh. Kështu ata nisën të shtonin edhe pronat, duke blerë disa hektarë tokë për kullota në Rrodokal e Niçë. Nga të dhënat e të moshuarëve, por edhe ata, që jetojnë sot, tregojnë se vetëm tokat në Rrodokal e kanë blerë 9,5 okë flori.

Gojëdhëna thotë se të dy palëve u është dashur tre ditë për t'i numëruar. As sot nuk mund ta dimë dhe ta konvertojmë vlerën e kësaj prone! Pasi blenë këtë pronë, vendosën të ndahen. Isufi dhe Ahmeti qëndruan në Jollë, ndërsa në Rrodokal shkuan: Rakipi, Mania dhe Mersini, më vonë shohim Rakipin atje, i cili nga viti 1953 shkon në Lushnjë, në fshatin Mizë, kurse Mania e Temja vendosen në Zgallë në tokat e Manastirit të Shën Marenës si bujq.

Në vitin 1930 shohim se vjen familja Elezi, bujq të Sherif Musait, Gjerja, Dakarja, Oll-dashi, Topalli në tokat e Manastirit. Kështu u bëmë disa fise, pra ishim anëtarë të Shën Marenës, ishim si në shtëpinë tonë. Ne kishim dhe një detyrim për Kishën: dy pjesë i mbanim vetë dhe një pjesë e merrte Kisha (Shën Marena).

KONTRIBUTE DHE VLERA SHOQËRORE...

Në vitin 1912 fisi Jolla përkrahu qeverinë e Ismail Bej Vlorës (Qemalit), se edhe këta e përjetuan sundimin turk. Bënin një jetë mjaft të vështirë, me taksa mjaft të rënda nga të huajt. Viti 1941. Lëvizja Nacionalçlirimtare po përhapej kudo, ajo kërkonte që populli të bashkohej dhe të shporrte pushtuesin e huaj, që po e shtypte dhe shfrytëzonte. Nga ky fis u bashkuan me Lëvizjen Rustem Jolla e SHEME Jolla, të cilët ndihmuan moralisht dhe materialisht. Kështu ky fshat u bë edhe bazë e Luftës Nacionalçlirimtare. Në Operacionin e Qershorit 1944 ne u dogjëm dhe u masakruam totalisht nga Balli Kombëtar. Po atë ditë, pasi dogjën çdo shtëpi e kasolle, morën 6 burra: Filen, Malon, Mahmutin, Kapon, Qamilin, Livanin, pasi i morën në sy të fëmijëve dhe të grave, i nisën për në komandën e Velçanit, duke marrë edhe 80 keca dhe lanë porosi që 500 krerë bagëti të vinin në Velçan, ndryshe këta do të vriteshin. Ditën e dytë porosia u nis për në Velçan, 400 krerë, kështu shpëtuan dhe burrat e fshatit. Një nga arsyet ishte se ky fshat ishte i lidhur me Llëngën.

Në këtë fshat kishte ardhur dhe kishte biseduar dhe Reshit Çollaku, në sheshin e Manastirit, ku ishte dhe spitali partizan. Ky fshat ka qenë shumë i pastër, nuk ka pasur as dje dhe as sot as të dënuar dhe as të burgosur.

JOLLA NË VITET E PASÇLIRIMIT...

Në vitin 1946 Reforma Agrare u dha tokën e Manastirit të Shën Marenës dhe nga ky vit nuk kishin më detyrime ndaj Manastirit, por ndaj shtetit. U bënë zotërit të tokës, duke filluar të punonin, shlyenin detyrimet dhe pjesën tjetër e mbanin për vete. Detyrimet i kishin nga blegtoaria, se bujqësia ishte e prapambetur. Shumë nga bashkëfshatërit nuk siguronin as bukën e gojës. Për këtë arsye i drejtoheshin pazarit të Korçës apo të Beratit, duke shitur prodhime blegtorale e duke blerë grurë, misër e të tjera. Në vitin 1958 shteti lëshoi thirrjen për t'u bashkuar si të gjithë fshatrat e rrethit për të krijuar kooperativat bujqësore. I gjithë fshati, pa hezitim u bë kooperativë: bashkoi tokat, qetë e punës, bagëtitë. Kryetar u zgjodh Rustem Jolla, llogaritar Bajram Elezi, magazinier Pëllumb Bega dhe brigadier Nazif Oll-dashi. Filluan të punonin më shumë për të përmirësuar jetën. Mungonte përvoja dhe drejtimi shkencor.

HAPAT E PARË NË FUSHËN E ARSIMIT DHE EDUKIMIT...

Deri në vitin 1958 ende nuk ishte hapur shkolla. Të rinjtë e të rejat kishin mësuar shkrim e këndim, në kurse jashtë kohës së punës me dritë pishe e kandili. Në këto kushte mësuan ABC-në e parë Kajo e Livan Jolla. Hysni Jolla, që është nismëtar i këtij punimi, në vitin 1985, kur nuk është më shumë se 8 vjeç, shkon e regjistrohet në një fshat më shumë se një orë largë. Aty vazhdoi për katër vite rresht, megjithëse ishte vetëm. Mbaroi 7-vjeçaren në konviktin "Muharrem Çollaku", Pogradec dhe u bë mësuesi i parë në këtë fshat, duke punuar nga viti 1970 dhe deri në vitin 2008 në të dy ciklet e shkollës 8-vjeçare, duke punuar gjithmonë me përkushtim e përgjegjësi.

Jo vetëm kaq kreu dhe një sërë detyrash të tjera shoqërore me organizatat e masave, kryetar Këshilli, deri në komisar batalioni dhe shef kuadri. Nga ky fis kanë dalë edhe kuadro të fushave të tjera: oficerë, agronom, veteriner, zooteknikë, ekonomistë, farmacistë, mjekë, të fushës së artit e të biznesit. Na vitin 1960 u hap shkolla fillore me sezon veror: 7 mars-29 nëntor. Shkolla u ndërtua në mesin e dy lagjeve: Jollë e Zgallë. Fillimisht mësimi filloi në shtëpinë e Rustem Jollës. Për të shkruar përdorin çantë e libër. Mësuesi i parë ka qenë Sherif Likollari nga Malina. Në shkollë u futën të gjithë dhe ata mbi 7 vjeç, kjo me baza vullnetare. Në vitin 1978 u ndërtua Shkolla 8-vjeçare në Jollë me 95 nxënës. Në fillim kjo shkollë ishte në varësi të drejtorisë Çemë e Hondisht, më vonë si qendër drejtorie në Bishnicë dhe më pas

drejtori e veçantë me tre mësues fillimisht.

Në këtë shkollë kanë punuar shumë mësues e mësuese nga Mokra, qyteti e zona të tjera, si: Sherif Likollari, Nuri Likollari, Mentor Kadilli, Hysni Jolla, Sami Leka, Fondi Vako, Rakip Elezi, Luan Miniri, Agim Xhe-lo, Jordan Bice, Shkëlqim Alia, Ariz Cani, Shaqo Çela, Ismail Qyrku, Koço Janella, Myftar Avdullai, Kozeta Fero, Vera Elezi, Hysni Fero, Adelina Gjera, Bejaze Ymeri, Djana Jolla, Tefta Topalli, Dhurata Topalli...Ndjesë, nëse kam harruar ndonjë. Në Arsimin Parashkollor kanë punuar: Miresire Jolla, Luljeta Bega, Sadete Qyrku.

Të gjithë nxënësit e kësaj shkolle kanë qenë të përkushtuar pas mësimit. Nga kjo shkollë dolën shumë kuadro të fushave të ndryshme. Zhvillimet demografike sollën si pasojë tkurrjen e madhe të shkollës. Ajo sot ka vetëm 2 nxënës, pra nuk flitet për shkollë e rendiment.

EKONOMIA, SHËRBIMET DHE VITET E DEMOKRACISË...

Vitet kalonin dhe kërkesat për jetën po rriteshin. Rustemi ia dorëzoi ekonominë Bajramit, Nazifit dhe Nazifit Hekuranit. Zhvillimi ekonomik po vinte gradualisht, duke kaluar gjithmonë e më lart, kujdes po treguhej edhe me kuadrin.

Si rezultat i kësaj pune u arrit të viheshin nën kultura 113 ha tokë, prodhoheshin 1000 kv drithëra buke, 1500 krerë bagëti, 13 pendë qe, 40 krerë lopë, 15 kafshë pune, një rendiment deri në 26 kv grurë për ha, por edhe 32-34 për ha, 50 litra qumësht për dele dhe 100 litra për dhi, 600 litra për lopë.

U arrit të merrej 11.3 lekë për ditë pune. U bë ekonomia më e mirë në zonë me 270 frymë dhe 95 forca pune. Kuadrot kanë qenë të aftë dhe kanë punuar fort, si kryetar Hekuran Jolla, respektin, që e gëzon edhe sot. Të gjithë anëtarët e ekonomisë furnizoheshin me të ardhura bujqësore e blegtorale.

Kuadro të fushave të ndryshme kanë qenë: kryetarë: Rustem Jolla, Bajram Elezi, Hekuran Jolla, Xhevahir Jolla. agronomë: Fatmiri, Hysniu dhe Tefiku. financier: Enveri, Shefkriu, Enver Ademaj. ekonomistë: Bukuria, Jetnori dhe Ismeti. veterinerë: Mehmeti, Hasani, Selamiu, Dervishi. brigadierë: Xheviti, Nazifi, Shazivari.

furrëtare: Safia, kuzhinieri Halimeja, Ramazania. magazinierë: Pëllumbi, Jemini, Myzja, Asllani. Sot nga 113 ha, që punohej, punohen vetëm 6 ha, të tjerat janë kthyer në kullota. Lëvizja e lirë e njerëzve bëri që nga fshati të largohen shumë familje dhe të vendosen në rrethe të ndryshme. Nga 45 familje, sot jetojnë vetëm 7 dhe nga 270 frymë sot ka 70. Shifrat flasin për një braktisje, nuk mendohet më për shkollë e shërbime të tjera. Përmirësimi i infrastrukturës do të bënte të mundur që banorët të rikthehen në fshat, do ta gjallërojnë ashtu si vite më parë, Jolla nuk është më shumë se 60 km nga qyteti. Kjo do të bënte të mundur të shkonte në punë diku dhe të kthehej përsëri në shtëpi. Do të rigjallëronin ekonominë personale, të cilën e kanë lënë, aty kanë varret e të afërmeve, të cilëve u janë larguar.

Në sistemin, që lamë pas, kujdesi shëndetsor ishte i njëjtë si në fshat dhe në qytet. Në vitin 1970 erdhi infermierja e parë, zonja Dafina Jolla, e diplomuar si infermiere-mami.

Punoit në këtë fshat për 36 vjet, sot pensioniste. Punoit me përkushtim, në shi e dëborë, ditë e natë. Në vitin 1985 u dekorua për punë të mirë e të palodhur. Puna e saj ndikoi që vdekshmëria në moshë të vogël të ishte, pothuajse zero.

Njëherë në dy javë vinte mjeku për vizita dhe shërbime të tjera, të cilat kryheshin në bazë të një plani. Sot në këtë fshat nuk kryhet asnjë shërbim shëndetësor. Në raste të ndryshme detyrohen të bëjnë 1 orë e gjysmë largë deri në Bishnicë për një vaksinë. Ka shkuar deri atje sa vetë fshatarët po mësojnë

Dita e dasmës është prerë
Me kohë stolia gati bërë,
Orkestra rëndë po buçet
Sa shurdhon njerëzinë e tërë.

Dasma nis daullet bien
Krushku bëri ftesat vetë,
Lart mbi mal zërat ngrihen
E çohen dallgët të kapin retë.

Ah kjo dasme hije rëndë
Spaska kafe as raki,
Nuk dashka mish as vere
Vetëm votën nusëri.

I kërkojnë votës besën
Pa no fol moj zonja nuse,
A do ta mbash vjerrën nënë
Apo do të behesh halla-huqe?!

Kush më bëri nuse mua
Dhe më veshi emrin zonjë,
Unë jam bijë e kësaj nëne
Jo nuk luaj me zakonë.

Pse në letër eci-shkoj
Nga tavolina në kuti,
Trokas fuqishëm e përgëzoj
Thellë në zemër cdo njeri.

Erë e lehtë jo sjam unë
As lodër për tu bërë,
Po jam gur e peshë e rëndë
Ku mbaj fatin për të tërë.

Hatri i shkesit për miqësi
E sy mbyllur të shkoj atje,
Të më martojnë me çyrykë



Vota nuse

Ramadan KLLOGJRI
(DANJA)

Pas ca kohe jam e ve.

Kush loz me mua bën mëkat
Nuk ja fal as perëndia,
Do ta zërë qafën poshtë
Me mallkim nga gjithë njerëzia.

Cilido që të më shesë
Apo pranon të më ndërrojë,
Nga pazari dritë-shkurtër
Mbetet shpejt me gisht në gojë.

Dhe ata që kërkojnë grada
Për tu stisur pashallarë,
Prapa tyre janë të tjerë
I shtyn për xhepat me dollar.

Mos më bëni plaçkë tregu
E të më nxirrni në pazar,
As si paçavure nëpër duar

Se ngarkoi me zarar.

Ty moj vota vendimtare
Të bëjnë nuse e nusëro,
Me pahir të japin burrë
Një pasha që ti se do.

Vota vlerë mbarësie
Dorë më dorë për qeveri,
Dëgjon shpejt flet avash
Për çka mbolle e çkorr ti.

Rrugë e shkurtë shkon më gjatë
Jo nuk i shkelet gjyshit varri,
As nuk harrohet qumështi i nënës
Që kapedan të quhet djali.

Qumështi i nënës është hallall
Për bijtë e saj si asllanë,
Zemra e nënës bëhet mal
Kur ndrisin yje për vatanë.

Llogaritë duhen bërë
Duke e matur sa më mirë,
Për njeriun vizionar
Vota jepet me dëshirë.

Atë mos e bëni nuse
Për ta martuar me një dru,
Po e conit ku u duhet
Që të shërbejë ca për ju.

Në fushatë është e bukur
E kërkojnë me zili,
Mbarojnë punë e hedhim tutje
E sdo ta dijë për të njeri.

Ato dyzet ditë nusërojnë

Sa dhëndurrët të zënë karrigen,
Pastaj shpejt rrudhen e plaken
E si kandili zënë e fiken.

O njeri të faltë zoti
Atë gur që ke në dorë,
Vëre atje ku ze vend
Që mos të shkrijë si dëborë.

Dil voto të heqish hallin
E mos lejo ta marrin vetë,
Se ke mend e ke gojë
Për tu ndier më i qetë.

Ata me sistem pazari
Që të mbajnë pozicionet,
Edhe kur su del hesapi
I krijojnë kualicionet.

Kush kandidon për zotni
E kërkon ta ngjitë malin,
Pse ka humbur ca para
Kualicion bën edhe me diallin.

Dhëndërrri djalë me taban
Nusja bijë e mbarë fisnike,
Bëjnë vatanin për familje
E ballë për ballë me karrige.

Ecim drejt e hapim rrugë
Me ide e hapësira,
Vrasim mendjen për më shumë
Dhe si të rritet më e mira.

Kështu i do toka mëmë
Bijtë e saj atdhetarë,
Me shpirt e zemër gjërë
Dhe të mbeten shqipëtarë.

t'i bëjnë injeksione njëri-tjetrit. Ja pra nga një shkëndijë e fisit Jolla e të tjerë u kthye në fshat nga Guri i Kuq në Jollë.

NJË VËSHTRIM PANORAMIKO-HISTORIK I FSHATIT JOLLË...

Fshati shtrihet 850-900 m mbi nivelin e detit, i rrethuar me pyje e kullota. Rriten shumë drurë e shkurre: pisha, bredhi, ahu, dushku, bushi, mëlleza, lajthia. Kufizohet me fshatrat: Llëngë, Hondisht, Shpellë, Kukurin e rrethit të Gramshit. Poshtë këtij fshati kalon lumi Shkumbin me dy degë: njëra në fshatin Llëngë dhe tjetra nga maja e Gurit Top dhe bashkohen poshtë Grykës së Gurit. Në të majtë të lumit gjarpëronte rruga "Egnatia", e cila lidhte Shqipërinë me Greqinë, duke kaluar në portën poshtë Llëngës dhe Voskopojës dhe më pas në Greqi në shekllin VI, kur u dyndën fiset sllave. Kjo rrugë shërbente për transport mallrash me karvane.

Lumi Shkumbin pas kaq e kaq shekujsh e ka zgjeruar shtratin, ka dëmtuar këtë rrugë, por edhe sot mund të geshë pjesë të kësaj rruge. Të krijohet ideja se në thellësi të shekujve ky lum do të ketë patur një pamje krejt tjetër nga kjo sot. Jeta ka vazhduar dhe kohët kanë ndryshuar, por reliket e asaj kohe dëshmojnë për një histori, që duhet ta dinë e ta vlerësojnë brezat.

Sot në afërsi të fshatit po ndërtohet një hidrocentral. Pasuria pyjore e kësaj zone i dha mundësi këtij fshati që në afërsi të tij të hapeshin dy sektorë shfrytëzimi: Tallë dhe Uji i Ftohtë, ku punonin gjithë vitin 80-120 punëtorë. Prodhojnë trupa e shtylla, dru zjarri, dhe traversa të përmasave të ndryshme.

Kjo ishte një ndihmë e madhe për fshatin dhe zonën përreth. Punonin në profesione të ndryshme. Në sektorin social punonin gra si banakiere, kuzhinierë, pastreuese, rrobolarëse, shitëse, magazinierë. Në Këshillin e fshatit kishim anëtarë nga këta dy sektorë. Në këta sektorë punonte parku i Pogradecit dhe i Përrenjasit për transport drusor. Çdo ditë nga këta sektorë ngarkoheshin 15-20 makina drejt Elbasanit, kohët e fundit drejt Pogradecit. Ky transport lehtësonte shumë edhe jetën e këtij komuniteti dhe të kësaj ekonomie për shumë probleme. Natyra i kishte falur këtij komuniteti një pasuri përrallore dhe për këtë uronim edhe Zotin e Madhërisëm.

Homazh për baba Islam Feron

Mësuam me dhimbje, se më 1 qershor 2015, u nda nga jeta, babai i dashur dhe i nderuar Islam Xhemal Fero.

Islami u lind më 15 korrik të vitit 1924 në fshatin Slabinjë të rrethit të Pogradecit, në një familje patriotike. Moshën e rinisë e kaloi në fshat me blegtori dhe në vitin 1944 e më pas me bujqësi.

Në 14 maj të vitit 1945 krijon familjen me Alije Balliun nga fshati Senisht i rrethit të Pogradecit. Pas çlirimit ndoqi kurset e shkollës që u hapën në atë kohë, për të mësuar shkrim e këndim. Në vitin 1947 e dërgojnë vullnetar në hapjen e rrugës së re Kukës-Peshkopi, ndërsa në vitin 1949 shkoi tre muaj vullnetar në hapjen e rrugës së Beragozhit në rrethin e Pogradecit.

Sherbimin e detyrueshëm ushtarak e fillon në nëntor të vitit 1949 në Brigadën e këmbësorisë në Përmet me detyrën e zbuluesit, dhe në janar 1950 transferohet në Gardën e Republikës në Tiranë duke shërbyer atje deri në vitin 1953.

Nga viti 1953 deri në vitin 1957 punon në bujqësi, nga shkurti 1957 bujk në kooperativën bujqësore të Slabinjës. Në ndërmarrjen e mirëmbajtjes së rrugëve në Pogradec, punon në vitet 1966-1968 dhe më pas përsëri vazhdon punën në kooperativë deri sa doli në pension në vitin 1989.

Në vitin 1954 pranohet antar i Partisë së Punës Shqipërisë dhe e dorëzon testeren me ndryshimet demokratike në vitin 1991.

Në çdo punë që ka kryer ka punuar me përkushtim, me ndërgjegje dhe me nder e krenari të lartë, cili po me këtë nder e përkushtim rriti edhe fëmijët e vet.

Në vitin 1996, me një dhimbje të thellë shpirtërore largohet nga fshati Slabinjë i Pogradecit dhe vendoset me banim në Sektorin Çermë (Tërbuf) në Lushnje me njërin nga djemtë Ramizin që i shërbeu me shumë respekt e dashuri për 19 vite që jetoi atje.



Me familjen e nderuar Alijen Islami lindi dhe rriti pesë djem të nderuar, me dorën, e vet të fuqishme, me sakrificat e tij u ka dhënë vetëm të mirën për jetën, për familjet dhe për të ardhmen e tyre.

Zenuni, Zeneli, Xhemali, Valdimiri e Ramizi u rritën krujan familjet e tyre dhe me familjet e tyre të nderuara, si Luljeta, Nënta, Donika, Sofika, dhe më e vogla Luli e cila i shërbeu me shumë respekt deri në minutat e fundit, me fëmijët e tyre, me kurora në dorë dhe me lot në sy e shumë dhimbje përcollën babanë e tyre të nderuar për në banesën e fundit. Ky është respekti dhe nderi i këtyre familjeve e fëmijëve të nderuar të Islam Feros, edhe ashtu ju takonte tia

bënin këtë respekt. Në këtë dhimbje nuk ishin vetëm të afërmit, miqtë dhe fisii i Islamit por edhe shumë shokë e miq të vetë Islamit, të djemëve të tij nga Tirana, Pogradeci, Mokra, Berati, Prrenjasi, Mati, Elbasani, Korça, Greqia, e Italia për të bërë respektin e baba Islamit dhe të fëmijëve të tij.

Të gjithë pjesmarrësit me lot e me dhimbje, dhe pa folur tregonin, respektin dhe të kaluarën e tij 91 vjeçare të atij burri i cili punoi jetoi dhe lragohet nga kjo jetë me respektin më të madh që na la mbrapa.

Mes shumë udhëtimeve të gjata e të mundshme ky ishte udhëtimi më i lehtë se u ndje i ndihmuar nga të gjithë dashamirësit e tij. Islam Fero ndahet nga jeta e tij e gjatë kur ai nuk rrinte kurrë për njerëz, pa miq, pa shokë, pa muhabet e pa këngë Mokrare. Ai punoi gjithmonë pa u lodhur dhe shkon i hijshëm duke mbetur i nderuar në kujtimet tona.

Islami është inisiatori duke dhënë ndihmesën kryesore me kujtimet e tij për hartimin e Librit "Slabinja e Jonë", Tiranë 2005 nga djali i tij Zenuni, ai ishte aktiv, në kujtesën tijë me të kaluarën, hstorike të fashtit Slabinjë, të fisit Fero e më gjërë.

Ai kishte shumë shokë e miq në gjithë Shqipërinë, dhe gëzonte me simpati e gjithë shpirt kur ata gëzoheshin, dhe hidhërohesh kur ata hidhëroheshin. Takimi me të ishte vetëm buzëqeshja mikpritja, e muhabeti me shumë tradita të mrkullueshme të zonës së Mokrës. Për të gjitha këto ai do të mbetet i pa harruar në mendje dhe në kujtimet e të gjithë atyre që e kanë takuar e bisdeuar me të, i ndritë gjithmonë buzqeshja e tij.

Në emër të familjes, të miqëve, të fisit dhe të Shoqatës Atdhetare e Kulturore "Pelioni" e të gazetës "Mokra" ju shprehim ngushëllimet më të sinqerta.

I pa harruar qoftë kujtimi i tij!

I lehtë qoftë dheu atje ku pushon

Zabit CUKU

Nënkryetar i Shoqatës "Pelioni"

Koloneli i sapodalë nga burgu

Nga Miltiadh DAVIDHI

Isha duke biseduar me dy shokë, kur dëgjova një zë të njohur dhe të dashur për mua, që po më thërriste në emër. Ktheva kokën nga më erdhën tingujt dhe pashë në anën tjetër të rrugës, në trotuar, Kolonelin. Ju kërkova leje shokëve dhe shkova e takova. Më shikonte me po ata sy të qetë, të urtë e të dashur si përherë. Megjithatë fytyra i kishte marrë një ngjyrë të verdhë, të zbetë e të lodhur, me shumë rrudha të shuara, e cila dhe pse mundohej të buzëqesh-te kishte një ndryshim si nata me ditën nga ajo e bardha, e bukura, diellorja që shndriste pa një rrudhë, përpara se të futej në burg. Trupi i drejtë, muskuloz e i fuqishëm kishte filluar të deformathej, të kërrusej, të mpakej. Ndryshim i përshpejtuar në dy kohë të ndryshme, para burgimit dhe pas tij, megjithatë pak vite kish bërë, se e kishin liruar. Por pafajësia e burgosur e kishte mundur.

-Erdha të takoja babën,-tha,- e ishte rënduar shumë... Nëna më vdiq kur isha në burg... mbase unë ia përshpejtova ikjen... por sa më gëzove, se nuk kisha më as numërin e telefonit tuaj... E përqafova fort mikun tim, atë njeri të thjeshtë, të urtë, të dashur, punëtor të palodhur e të ditur, me disa gjuhë të huja, ku pëktente e përsoste materialet ushtarake, duke i botuar në libra, që njihet e respektohet nga shumë shtete për njohuritë ambicioze ushtarake që kishte. Ndjeva dhimbje për këtë ndryshim të beftë, si në fytyrë, në trup e në ndjenja, por njëkohësisht dhe u gëzova që më në fund kishte fituar lirinë. Mu kujtua, që ai sapo kishte dëgjuar e lexuar emrin në listat e atyre që ishin dënuar në gjyqin e montuar, ishte i vetmi që kishte marrë batanijen e disa rroba dhe ishte dorëzuar me dëshirë në burg, megjithatë i pafaj, ndërsa shkaktarët kryesor të Gërdecit, kishin ikur nga vendi dhe kishin fituar azil politik në shtete të tjera, ku as sot e kësaj dite nuk kanë bërë as dhe një ditë të vetme burg, e ministri i Gërdecit, si udhëheqës i një partie politike, bën fushatë që sërish të bëhet ministër mbrojtje për një tjetër Gërdec. Ndjeva neveri ndaj politikanëve të këqinj të vendit tim, që vetëm mashtrorinë me fjalë të bukura, ndërsa gjurmët që lenë pas janë tinëzare dhe vrasëse për këtë popull e këtë vënd. Koloneli kur ndodhi Gërdecit nuk ishte më në detyrë e kolonelit, kishte dy vjet i veshur civil në një detyrë tjetër, që s'kishte lidhje fare me ngjarjen e tmerrshme dhe të përgjakshme. Por peshku i madh gjithmonë e ha peshkun e vogël e të pafajshëm. Herën e fundit që e takova, i thashë ta merte më seriozisht e të takonte Kryeministrin e t'ia sqaronte situatën e tij, ndryshe do përfundonte në burg. Ai qeshi tek sa rrinte i qetë, duke mos e menduar kurrë se do të përfundonte brënda në qeli.

-Unë jam i pafajshëm,-më tha,-ndaj s'kam pse të kem frikë! Kam besim tek drejtësia. Ata nuk kanë as një fakt të më dënojnë... dhe s'kam arsye të trembem e ta takoj. Më njohin mirë kush jam, e dinë punën time, njohuritë e mia, dhe më kanë vlerësuar përherë! Atëherë, nga merak se mund të ndodhte ndryshe, i tregova fabulën e luanit me lepurin.

-Kur mbreti luan dha urdhër, që të gjitha kafshët me brirë të pyllit të largoheshin sa më shpejtë prej tij, i pari që po vraponte me sa fuqi që kishte për ti shpëtuar të keqes, ishte një lepur. Dhelpra i doli përpara duke qeshur dhe e qesëndisi:

-Po ti, more lepur, nuk hyn në kafshët që kanë brirë, pse po largohesh me kaq shpejtësi?!

-Sa ta mar vesh çdo luan, që nuk kam brirë, mua më kanë bërë kurban, u përgjigj lepurin dhe vrapoi të largohej! Koloneli pasi



kuptoi mesazhin e fabulës, qeshi dhe më tha të mos kisha merak, se nuk do ndodhte asgjë e tillë, dhe rrufti kafën e zezë, duke i mbetur buzëqeshja e ngrirë në fundin e filxhanit. Ndoshta nga rrathët e së keqes së zezë, ndjeu dhe ai, diçka të cilën nuk mund ta besonte. Por situata donte sa më shumë kurban me njerëz të pafajshëm, që të shpëtonte të fajshmit, dhe Qeveria t'i thoshte popullit:

-Ja, fajtorët vajtën para drejtësisë! Këta janë brirë mëdhenjtë që shkaktuan katastrofën e Gërdecit!

-Ky është nipi im,- më tha për shoqëruenin e tij, duke më shkëputur fillin e kujtimeve. Ai kishte fytyrë të bukur dhe ishte i qeshur, duke i ngjarë shumë dajës që kishte në krahë para se të burgosej. U ndjeva mirë midis tyre.

-Më ka kapur gripi,-vazhdoi të fliste,-dhe tashmë s'më ndahet për muaj të tëra. Më ka rënë imuniteti i organizmit në burg!

-Dihet i thashë,-sa më shumë stres të kesh, aq më tepër bie imuniteti i trupit!

-Harroje- vazhdova,-tashmë e keqa mbeti pas, dhe ti je i lirë si gjithë të tjerët në familjen tuaj të mrekullueshme, mes shokëve që të respektojnë e të duan si më parë, ndaj largoje stresin nga vetja sa më shumë!

-Po,-tha,-shokët më vinin çdo ditë në burg dhe më dhanë shumë kurajo e forcë, e sërish ndihem i lumtur mes tyre, duke ma pakësuar stresin! Mua mëndja më shkoi disa vite më parë kur koloneli ishte kolonel në pushtet, e jo si tani në pension të parakohshëm. Megjithatë nuk kishte asnjë dokument partie, zotësia në zanatin e vet, ishte i vetmi dokument partie me të cilin ai prazantohej përpara secilës parti politike.

Po kush ishte Koloneli Zenun Ferro? Një student që kishte mbaruar shkollën e lartë të oficerëve në specialitetin e armatimit e monucionit, një njeri i përkushtuar mbas

shkencës ushtarake, një gazetar e shkrimtar. Mbas një eksperience 7-8 vjeçare në garnizonet e Burrelit, thirret urgjent, brënda ditës në strukturimin e arsimit të shkollës së lartë të bashkuar ushtarake, ku do jepte këto lëndë të veçanta me pasion e përkushtim. Pamvarsisht vazhdimësisë së konjukturave politike, ai mbijetoi, dhe në shkurt 1998 emërohet specialist i municionit në shtabin e përgjithshëm. Por mua, në kujtesë më kishte mbetur një sasi prej rreth 80 kg zhive (nitrat plumbi) për mbushjen e kapsollave të fishekëve e sjellë nga pala kineze shumë kohë më parë, dhe që ishte kthyer në një rrezik serioz për gjithë banorët e zonës së Çorovodës dhe më gjërë. Ajo ishte nga lëndët më të rrezikshme të kohës e kërcënuar nga goditjet, shpimi, pamundësia e lëvizjes, transportit, dhe me shumë vështirësi e enigma të frikshme si pasojë e mungesës së njohurive të plota për eliminimin e saj. Gumëzhinin gazetatat, stacionet televizive për këtë sasi zhive, që pas shpërthimit të Gërdecit mund të krijonte një Gërdec të ri. Ishte pikërisht Zenun Ferro, personazhi i këtij tregimi i caktuar nga Ministria e Mbrojtjes, i cili e mori përsipër asgjësimin, duke lënë me gojë hapur dhe specialistët më të mirë Rusë dhe Amerikanë, e zgjidhur këtë enigmë të frikshme dhe vrasëse. Më ka mbetur i paharruar në kujtesë ky demontim. Ishe një ditë me qiell të vrenjtur plot me ankth pritje për njerëzit, ku disa rreze dielli herë dilnin, e herë fshiheshin pas reve, sikur të kishin frikë nga kërcënimet djegës e vrasar, që mund tu ndodhte gjatë shkatërrimit të asaj sasive zhive, të tmerruara nga ajo ç'ka kishin përjetuar gjatë shpërthimit plot llahtari të Gërdecit, kur u dogjën e u shkrumbuan mes flakëve, rrezet e diellit, ajri, toka dhe të vdekurit. Si të kishte ndodhur një shpërthim i papritur dhe i tmerrshëm vullkani. Inspektimet e bëra nga grupi i reduktimit të rreziqeve në të gjithë botën, këtë sasi të konsiderueshme zhive, si dhe gjithë monicionet e tjera, i vlerësoi si një nga më të rrezikshmet në të gjithë Shqipërinë, dhe u tërhoq për të dhënë rekomandimin, pa pyetur inxhinjerët e kimistët në Sh.B.A. Me këto kushte pala Shqiptare me disa specialist më në krye Kolonelin, e studjuan këtë fenomen dhe vendosi, që e vetmja mënyrë ishte asgjësimi duke e mbushur depon me 2-3 metro ujë dhe djegien me një nga lëndët djegëse si vajguri, benzinë ose naftë, dhe si të arrihej ky proces, të bëhej shpërthimi me plasje. Njerëzit kureshtarë e të frikësuar të asaj zone dhe ekipi i Ministrisë më në krye ministrin e asaj kohe, Gazmend Oketa, e ndiqnin 3-4 km larg me habi, merak e kuriozitet të lartë, se çfarë do ndodhte gjatë këtij demontimi që kryhej për herë të parë në Shqipëri prej specialistëve tanë. Ndodhi një mrekulli, një plasje e butë, se zhiva ishte ngopur e amortizuar me ujë, dhe një re e bardhë tymi e dëndur, dhe e

plotë, u ngrit mbi 500-600 metra lartësi, si një psherëtimë e mbytur, e u largua prej forcës së erës, duke u shpërbërë e dhënë shpirt mbi shpatet e malit të Tomorrit të mbuluar me një dëborë të bardhë shprese, qetësuese e shpirtrave të djegur e të lodhur nga pasiguria në këtë vënd. Kjo metodë bëri të habiteshin dhe ekspertët Amerikanë e nga ajo ditë, specialisti e Koloneli Zenun Ferro, u emërtua prej tyre "PROFESOR I SHKENCËS USHTARAKE TË MUNICION-EVE".

-Do vini të pimë një kafe bashkë?-më tha Zenuni, duke m'i ndërprerë mendimet e më sipërme.

-E kam për nder të pi një kafe me Ju, kolonel,-i thashë, e një pikë loti më kishte njomur qerpikët që mundoheshin ta fshihnin nga turpi prej tij, (njësoj si në ditën kur e mora vesh lajmin e dënimit prej televizorit), nga këto padrejtësi shokuese që ndodhin, ndaj njerëzve të mirë e të ditur, specialistëve që për njohuritë e tyre, vendi ka kaq shumë nevojë të ecë përpara. E vranë moralisht, shpirtërisht, duke e dënuar e ia shkatërruar jetën, dhe kur ai, s'ishte fare në atë detyrë, prej dy vjetësh! Ecja krahi tij dhe ende s'doja ta besoja që një njeri i tillë të ishte dënuar me burg, kur për shumë seanca gjyqësore ishte thirrur si ekspertë! Kërcim spektakolar, nga ekspert në të pandehur! Ndoshta ju duhej dhe një tjetër për të plotësuar numërin e urdhëruar nga lart, dhe me Zenunin e plotësonin atë? Por, gjithsesi duhet të jetë i kënaqur, mendova, që e kishin liruar pas 20 muaj, pasi i ishte falur një vit nga amnistia. Si pasojë e sjelljes së mirë, kishte fituar dhe katër muaj leje shpërblyese, ku mbas tre vjet hetimesh, ishte dënuar me tre vjet heqje lirie. Se mund ta kishin kalbur në burg dhe ec e ta gjente të drejtën! Dhe me kaq, me shpirtin e tij të qelqtë, e kishte përjetuar aq keq, sa me ndryshimet në fytyrë, trup e thellë në shpirt, dukej sikur dilte pas shumë vitesh burg. Por po ta shikoje më me kujdes e thellë në sy, kuptoje që sytë e tij ishin të ëmbël, të qetë e të butë si dikur, pa më të voglën e urretje për ata që e kishin dënuar, dhe e kishin shkatërruar në fundin e karrierës, padrejtësisht. Ai të gjithë i kishte falur. Sytë dhe zemra e tij me shikimin shumë larg, tek e ardhmja, sikur thoshin:

-Është koha ta duam këtë vend, dhe kësh-tu, me paradokse të tilla të çmëndura. Të jemi gati të sakrifikohe mi për të, siç kanë bërë të parët tanë, e do bëjnë të gjithë ata që do vijjnë pas nesh! Dhe pse i flakur, kishte mbetur një ushtarak i betuar dhe një patriot i palëkundur. U ndjeva kranar për shokun tim. Me njerëz të tillë duhet të krenohemi të gjithë dhe duhet të nxjerrim mësim nga këto përvoja të hidhura, ku e bardha bëhet e zezë dhe e zeza e bardhë, ku fajtori del i pafaj dhe i pafaj fajtor.

Dt.02.04.2015

SHENIME PER LIBRIN "PAKT ME TE HENEN"

Këto ditë festuam Nr. 200 të gazetës "Mokra" dhe zgjedhjet për kryesinë e shoqatës "PELIONI". Z. Istref Haxhillari u zgjodh kryetari i saj.

"....Pakt me të hënë" është libri ...i fundmi që na dhuroi... Porbrilante janë edhe fjalët e Tij.

"Gazeta Mokra"- thekson Ai, - "më bëri shkrimtar..."

"....Pakt me të hënë..."Ndoshta në gen? Apo i lindur...i dashuruar pas letërsisë ...

Ai na çfaqet me madhësinë e sin-

qeritetit fëmënor... "Se një ditë ...,kur vajti me babain në Pogradec.... I vogël 5-6vjeç tek shitësi me emër gruajë bleu një libër për fëmi..."

....Dhe nxënësi Brillant në mësimet që nuk na e thotë kurrë... "Tre herë shkrova fjalën magjike "letërsi" për studimet e larta por e çuan për fizikë..."

Dhe kur e pyesin për librin e tij të parë "dobët"-thotë "nuk do të desha ta kasha shkruar"

....Por me dy veprat e tij të fundit ai të befason artistikisht." PretencaPakt me të Hënë"... Risi e letërsisë bashkëkohore.

Elokuenca e të shprehurit ,përzier me çiltërsinë e shpirtit të tij fisnik,rrëfimit të tij I japin vlera sa artistike dhe filozofike.

Duket se "Artisti"i fjalës së shkruar ,ka arritur në majat e pjekurisë së tij për të prodhuar "Art",në plot kuptimin e fjalës por edhe sin ë mendimtar i spikatur i një eksperti të shkencave ekzakte...

"PAKT ME TË HËNËN"....Hape në cilën faqe që të dëshirosh....

...Dhe në çdo copëz ,do të mrekullohesh nga magjia e bukurisë artistike ...Thjeshtësisht...

URIME!!!

Hiqmet HYKO